



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.926/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Gyltene Zeka, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Gyltene Zeka kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, në Vendvotimin: 1704y/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimin si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.926/2017 me datën 10.11.2017, e parashtruar nga Gyltene Zeka kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ, nuk figuron vota e nënës së saj e cila ka votuar në cilësinë e personave me nevoja të veçanta . Po ashtu ka theksuar se në vendvotimin 1704y/02R, i është hequr një votë, pasi që në këtë vendvotim ajo ka pasur dy vota nga familjarët, të cilat vota kanë figuruar në FRK, mirëpo në rezultatin përfundimtar i figuron vetëm një votë.

Parashtruesja e apelit ka bashkangjitur formularët për përputhje të të dhënave dhe rezultateve si dhe tabelat e rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet e parashtrueses të apelit janë të bazuara për faktin se pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalë nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Paneli në mbështetje të nenit 117.4 e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit të vendimit.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura PZAP-i vendosi si në pjesën II të dispozitivit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.926/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesues i Panelit
Zyhdërit Haxhiu



Udhëzim Juridikë:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*